

VENDIM
Nr. 6, datë 9.1.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11, DATË 11.1.2024, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s,
“AEGEAN SEA”, NË DETIN EGJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 11, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s, “*Aegean Sea*”, në detin Egje”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi “... 22 (njëzet e dy) ushtarakë ...” zëvendësohet me “... 23 (njëzet e tre) ushtarakë ...”;

b) Në pikën 4, fjalia “Kohëzgjatja e këtij misioni është 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.” zëvendësohet me “Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31.12.2028.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama